



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 18.09.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-922/24-B, për zyrtarin e lartë z. Bariu Zenelaj, ud. Drejtor i Departamentit të Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Bariu Zenelaj, ud. Drejtor i Departamentit të Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik të zyrtarëve të lartë të sipërpërmendur, ku theksohet se (citojmë nga kërkesa): "Po iu shkruajmë [...] lidhur me ndarjen buxhetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për projektet e OJQ-ve kosovare në art, kulturë dhe trashëgimi kulturore. Sipas rezultateve të publikuara, lista e përkrahjes përmban financimin e disa OJQ-ve, të cilat dyshohet se kanë lidhje me [...] anëtarin e Komisionit Vlerësues, Bariu Zenelaj. Saktësisht bëhet fjalë për [...] OJQ 'Plan' e cila drejtohet nga A. Sh., mik dhe ish-koleg i anëtarit të Komisionit, Bariu Zenelaj. A përbëjnë konflikti interesi ndarjet buxhetore të MKRS-së për këto OJQ?"

Konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia përmes shkresës zyrtare (APK-DPKI-06/960/24), ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Bariu Zenelaj, lidhur me fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

I. Me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të pretendimit të ngritur nga raportuesi i rastit për zyrtarin e lartë z. Bariu Zenelaj, ud. Drejtor i Departamentit të Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin e lartë në fjalë, me ç'rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit si dhe me informatat që posedon Agjencia lidhur me këtë rast.

Në takim, zyrtari i lartë ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me rastin në fjalë, duke theksuar se lidhur me projektin “*Isopolifonia për Adem Jasharin*”, me të cilin ka aplikuar OJQ “*Plan*”, përmes përfaqësuesit të autorizuar të saj A. Sh., *deklaroi me përgjegjësi të plotë se, raportet e mia me A. Sh. nuk janë raporte miqësie, por raporte sikur me çdo ish-kolegë tjetër më të cilët në të kaluarën na ka lidhë veprimtaria e njëjti në fushën e Organizatave Jo-Qeveritare.*

Në takim z. Zenelaj ka deponuar edhe dokumentacion relevant lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit përkitazi me OJQ-në “*Plan*”. Ndërsa, në kompletim të dokumentacionit dhe sqarimit të mëtutjeshëm të rastit në fjalë, Agjencia ka kërkuar dhe mbledhur informacion dhe dokumentacion shtesë nga z. Bariu Zenelaj dhe institucionet përkatëse relevante.

Në deklaratën e dërguar Agjencisë nga zyrtari i lartë z. Bariu Zenelaj, theksohet se (*citojmë*): *“[...] Unë, Bariu Zenelaj, jam ndoshta ndër themeluesit e parë të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë. Rrugëtimin tim me OJQ e kam filluar që nga ditët e para të pasluftës në Kosovë me 1999, me një agjencion humanitar amerikan, të quajtur [...] nga New York`u, rrjedhimisht SHBA`të. [...] Në këtë rrugëtim të gjatë, unë kam njohur shumë përfaqësues të OJQ`ve dhe në mesin e tyre edhe të apostrofuarin ztr. A. Sh. i cili atë kohë punonte për një OJQ të fuqishme amerikane, të quajtur [...]. Duke i mohuar gjithnjë relacionet familjare (kurrfarë relacionesh familjare), me të apostrofuarin ztr. A. Sh., ne si përfaqësues organizatash të shoqërisë civile, kishim aktivitete ku takoheshim si kolegë të sektorit jofitimprues, si seminare, punëtori, trajnime, fushata avokimi, takime koordinuese e planifikuese për çështje të ndryshme të cilat ishin në domenin e punës së OJQ`ve. Dhe kështu si nismëtarë i themelimit të OJQ`ve në tërë Kosovën, unë kam patur mundësinë dhe fatin të njohë shumë njerëz, Andaj "mik" [...] sikurse ztr. A. Sh., unë kam në tërë Kosovën. Që nga fillimi i vitit 2019`të, unë punojë në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, fillimisht si përgjegjës i Zyrës së MKRS-së në Prizren, dhe që më pak se një vit jam transferuar në MKRS Prishtinë, përkatësisht Departamentin e Trashëgimisë Kulturore, në cilësinë e ud. Drejtorit të DTK-së. Për deklaratën e dhënë si më lartë, unë mbajë përgjegjësi të plotë morale dhe ligjore! [...]”.*

Me vendim Nr. 692/2024, datës 30.04.2024, sekretari i Përgjithshëm i MKRS-së formon Komisionin për vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve, sipas thirrjes publike “Projekt propozimet në fushën e Artit, Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore për vitin 2024”, ku në përbërje të këtij komisioni në cilësinë e anëtarit bën pjesë edhe z. Bariu Zenelaj.

Agjencia ka analizuar me kujdes pretendimet e raportuesit të rastit për konflikt të mundshëm të interesit lidhur me rastin konkret, deklaratat, sqarimet dhe dokumentacionin e dërguar nga z. Bariu Zenelaj me kërkesë të Agjencisë, si dhe provat tjera të siguruara sipas detyrës zyrtare, dhe pas konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, për zyrtarin e lartë z. Bariu Zenelaj, ud. Drejtor i Departamentit të Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e



Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pasi që nuk është gjetur se zyrtari i lartë në fjalë e ka *Person të afërm* personin A.SH., në kuptim të nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Fillimisht, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare".

Ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se:

"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiq nga kjo vendimmarrje."

Lidhur me nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

"Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste",

si dhe me nënparagrafin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se:

"person i afërm me zyrtarin është bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. [...]."

Ndërsa dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definojnë nocionin vendimmarrje si:

"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."

Pra, në kuptim të dispozitave të sipërcituara, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes, nën kushtet e ekzistencës së interesit privat të zyrtarit apo të personave të afërm me të, në një çështje të caktuar. Për tu konstatuar konflikti i interesit në një çështje të caktuar, duhet të plotësohen kushtet thelbësore (kumulative) të tij, siç është vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes si dhe interesi privat i zyrtarit ose i personave të afërm me zyrtarin.

Kësisoj, Agjencia ka trajtuar pretendimet e raportuesit të rastit sa i përket afërsisë ndërmjet zyrtarit të lartë z. Bariu Zenelaj dhe përfaqësuesit të OJQ-së "Plan", dhe me këtë rast nuk ka


gjetur e as konstatuar ndonjë lidhje biznesi/afarizmi, afërsi apo lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jo-pasuror në mes tyre, prandaj, siç u tha më lartë, personi A.SH., nuk mund të konsiderohet person i afërm i zyrtarit të lartë në fjalë në kuptim të dispozitave të sipërcituara të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Në këtë mënyrë, përkundër vendimmarrjes ekzistuese në rastin konkret, në mungesë të plotësisht të kushtit tjetër kumulativ (afërsia me personin zyrtar), në rastin konkret përjashtohet konflikti i interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Agjencia nuk ka trajtuar e as paragjykuar procesin e subvencionimit, respektivisht mbështetjes së projekteve të kulturës, rinisë, sportit e trashëgimisë kulturore në MKRS, për sa i përket rregullsisë, procedurave të vlerësimit dhe përzgjedhjes së përfituesve të subvencioneve apo aspekteve tjera ligjore, të cilat rregullohen me legjislacion përkatës si dhe akte nënligjore të brendshme (si: Rregullorja MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Rregullorja e (MKRS) - Nr. 09/2015, për subvencionim në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore, rinisë dhe sportit, etj.), kjo edhe në përputhje me nenin 20, paragrafi 3 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku është përcaktuar se: "Institucionet në kuadër të akteve të tyre të brendshme, parashohin dhe zbatojnë rregulla të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit, varësisht fushëveprimit të institucionit përkatës".

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: "Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.", si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: "Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative."

Nga sa u tha më lartë, duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:


YLLI BULESHKAJ
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)